

20181632977

**LIGJ PËR GARANCI TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË TË DETYRIMEVE SIPAS MARRËVESHJES PËR HUA, TË DEDIKUAR PËR FINANCIMIN E NDËRMARRJEVE TË VOGLA DHE TË MESME DHE PROJEKTEVE TJERA PRIORITARE- FAZA V, E CILA DO TË LIDHET NDËRMJET BANKËS INVESTUESE EVROPIANE DHE BANKËS MAQEDONASE PËR MBËSHTETJEN E ZHVILLIMIT**

Neni 1

Republika e Maqedonisë e garanton përmbushjen e detyrimeve nga Marrëveshja financiare për sigurimin e huas për Projektin për financimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe projekteve tjera prioritare - faza V në shumë prej 100.000.000 euro, e cila do të lidhet ndërmjet Bankës Investuese Evropiane dhe Bankës Maqedonase për Mbështetjen e Zhvillimit, nëse Banka Maqedonase për Mbështetjen e Zhvillimit nuk i plotëson dhe servison detyrimet në afate dhe kushte të parapara në Marrëveshjen financiare.

Neni 2

Kushtet dhe mënyra e shfrytëzimit të huas nga neni 1 i këtij ligji, përcaktohen me Marrëveshjen financiare, e cila do të lidhet ndërmjet Bankës Investuese Evropiane dhe Bankës Maqedonase për Mbështetjen e Zhvillimit sipas Projektit për financimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe projekteve tjera prioritare -faza V.

Neni 3

Të gjitha detyrimet financiare të cilat dalin nga Marrëveshja financiare nga neni 1 i këtij ligji do t'i servisojë Banka Maqedonase për Mbështetjen e Zhvillimit.

Neni 4

Huaja nga neni 1 i këtij ligji do të tërhiqet në më së shumti 20 transhe. Shuma minimale e transhesë është 5.000.000 euro.

Afati i pagesës të secilës transhe të huas mund të jetë nga së paku katër vjet deri në më së shumti dymbëdhjetë vjet nga data e tërheqjes së transhesë, me grejs periudhë të përfshirë që mund të jetë ndërmjet 30 ditësh dhe katër vitësh nga data e tërheqjes së transhesë.

Afati i pagesës së huas do të përcaktohet për secilën transhe veçmas në ditën e dorëzimit të kërkesës për tërheqjen e mjeteve të huas nga Banka Maqedonase për Mbështetjen e Zhvillimit.

Transheja mund të paguhet edhe në mënyrë të njëhershme në ditën e cila është ndërmjet tre dhe pesë vjet nga dita e tërheqjes së transhesë.

Neni 5

Shkalla e kamatës do të përcaktohet për secilën transhe të huas veçmas, në ditën e dorëzimit të kërkesës për tërheqjen e mjeteve të huas nga Banka Maqedonase për Mbështetjen e Zhvillimit.

Neni 6

Për rregullimin e të drejtave dhe detyrimeve të ndërsjella, të cilat dalin nga Marrëveshja financiare dhe Marrëveshja për garanci, Ministria e Financave dhe Banka Maqedonase për Mbështetjen e Zhvillimit do të lidhin marrëveshje të veçantë.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".